

Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

1.Objekti dhe Kontributet

Organizimi

Shoqeria "Media Vizion" sh.a eshte krijuar si shoqeri aksionere me tre aksionere me vendin Gjykates Nr.22885 dt.03.02.2000. Ne baze te ketij vendimi 35% e aksioneve i takojne z.Artan Dulaku, 30% e aksioneve z.Agim Buxheli dhe 35% z.Genc Dulaku. Drejtor i pergjithshem i shoqerise eshte z.Agim Buxheli.

Me vendim Nr.22885/1 dt.12.5.2000 eshte emeruar eksperti per vleresimin e kontributeve ne natyre.

Me Vendim Nr.22885/2 dt.11.09.2000 eshte bere zmadhimi i kapitalit ne baze te Aktit te vleresimit te kontributeve ne natyre ne shoqeri.

Me Vendim Nr.22885/3 dt.10.09.2001 z.Agim Buxheli i ka shitur aksionet e tij z.Adrian Dulaku dhe eshte larguar si drejtor i pergjithshem i shoqerise.

Me vendim Nr.22889/4 dt.14.05.2004 ortakët e shoqerise i kane shitur 25% te aksioneve z.Matteo Scalco. Drejtor i shoqerise eshte emeruar z.Genc Dulaku. Gjithashtu eshte miratuar ndryshim ne keshillin mbikqyres.

26/11/2007 eshte bere zmadhim kapitali , eshte larguar ortaku Mattei Scalco dhe eshte shtuar ortaku Eleonora Comarin

Me date 27/06/2008 eshte vendosur shitja e kuorave te kapitalit ne masen 29.27% shoqerise ortakut OST Holding GmbH dhe 19.76% ortakut Spot AG.

Me dt 8/7/2008 kane ndryshuar perqindjet ne pjesemarjet e kapitalit

Ortaku Spot AG eshte terhequr dhe aksionet i kane kaluar Media Holding Beteiligungs.

Me date 17/07/2012 kane ndodhur ndryshime ne aksionere dhe ne % e tyre te cilat reflektohen me poshte.


Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave perkatese te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

Objekti dhe Kontributet

Shoqeria ka si objekt ushtrimin e veprimtarise Radio-Televizive e cila konsiston ne krijimin e nje rrjeti Radio-Televiziv me shtrirje ne te gjithe vendin si nepermjet mbulimit direkt te territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe nepermjet mbeshtetjes ne median rajonale me shperndarje nepermjet valeve si dhe via kavo.Pjeset e aktivitetit do te jene gjithashtu prodhimi,tregetimi dhe shperndarja e programeve te ndryshme radio televizive si dhe video-audio kasetave ne formate te ndrshme, profesionale ose jo, bashkepunimi me rrjete televizive te huaja dhe perfaqesimi reciprok i tyre si dhe aktivite te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe cdo aktivitet tjeter te nevojshem ose te dobishem per ushtrimin e veprimtarise radio-televizive.

Ne vitin 2019 kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin ne veprimtari Televizive.

Kontributi ne shoqeri ne daten 31/12/2019 perfaqesohet nga kapitali i ortakeve si me poshte:



Artan Dulaku
Adrian Dulaku
Genci Dulaku

% ne Kapital	Vlera e kapitalit
33.33	117,655,000
33.33	117,655,000
33.33	117,655,000
100	352,965,000

Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

Pronesia mbi Aktivet

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne ambiente ndertese ne pronesi te shoqerise Aktivet e saj perbehen nga, ndertesa, makineri dhe paise pune dhe inventar ekonomik.

Kapitali

Kapitali i shoqerise prej 352,965,000 leke eshte kapitali i regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Administrimi

Shoqeria drejtohet nga Drejtori i Pergjithshem te cilit i perkasin te gjitha kompetencat per drejtimin ekzekutiv te pergjithshem. Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll te vazhdueshem per menyren ne te cilen Drejtoria administron shoqerine.

Numuri mesatar i punonjesve

Per vitin 2019 shoqeria ka patur nje numur mesatar punonjesish prej 173 punonjes.
Tarifa e auditimit eshte 360 mije leke.

2.Zbatimi i rregullave te mbajtjes se kontabilitetit

Kontabiliteti eshte organizuar dhe mbajtur ne pajtim me kerkesat e ligjit "Per kontabilitetin" dhe "Planin Kontabel te Pergjithshem". Veprimet jane regjistruar ne menyre kronologjike. Çdo veprim eshte mbeshtetur ne dokumenta justifikuese. Veprimet jane ngurtesuar me 31 dhjetor 2019.

3.Politikat Kryesore Kontabel

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin 25/2018 dt 10/05/2018 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera sipas "parimit të drejtave të kostatuara". Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë). Veprimet janë hedhur në menyre kronologjike dhe të kompjuterizuara në programin "FINANCA 5". Veprimet janë ngurtesuar me 31.12.2019.

Shifrat e bilancit të vitit 2019 janë të krahasueshme me shifrat e bilancit të vitit 2018, pasi janë zbatuar të njëjtat politika kontabel. Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2019 është zbatuar formati i SKK-2.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara, mbeshtetur në dokumentacionin justifikues. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të treta, dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura, duke u mbeshtetur në dokumentacionin justifikues.

Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më

31.12.2019 jane 1 euro= 121.77 leke dhe 1 dollar= 108.64 leke

31.12.2018 jane 1 euro= 123.42 leke dhe 1 dollar= 107.82 leke

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual, bazohet mbi fitimin e tatueshem, i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin per ushtrimin eshte 15 % .

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme. (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e vleren se mbetur per aktivevet e qendrueshme. Normat e perdorura jane sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" per makineri e paisje qe disponon shoqeria me 20% te vleres se mbetur, per paisje zyre dhe informatike me 25 % te vleres se mbetur , ndersa ndertesat 5% te vleres se mbetur.

Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjate perdorimit shkarkimi behet me kosto mesatare sipas kushteve te programit Financa 5.
 Shoqeria nuk ka gjendje inventari ne 31/12/2019.

4.Verifikimi i grupeve, rubrikave dhe posteve te bilancit

Çelja e vitit 2019 rakordon me mbylljen e vitit 2018. Gjithashtu shumat e kolones "Ushtrim i Mbyllur" si ne aktiv dhe ne pasiv te cilat kapin shumen 642,323,449 leke vlere e cila ka nje rritje nga viti kaluar 13,643,615 leke .

5. Aktivet Afatshkurter

5.a Mjetet monetare perfaqeson vlerat ne banke dhe ne arke.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Para ne dore	12,570,201	15,505,995
Para ne Banka	4,190,382	5,514,199
Totali	16,760,583	21,020,194

Shoqeria ka llogari likuiduese ne, Intesa Sanpaolo, B.K.T. Abi Bank, First Investement Bank, Alpha Bank, Pro Credit Bank, Tirana Bank, Union Bank,Raiffeisen Bank , OTP Bank ,Credins Bank.

5.b Aktive te tjera afatshkurter financiare perfaqesojne vleren e kliente te pa arketuar dhe vleren e tatimeve te mbipaguara si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kerkesa te arketueshme	234,549,308	250,336,552
Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	59,575,390	898
Totali	294,124,698	250,337,450

5.b.1. Llogari Kerkesa te arketueshme detajohet:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kliente		
Pa arketuar deri 6 muaj	54,384,535	58,045,095
Pa arketuar deri 1 vit	40,788,073	43,533,471
Pa arketuar mbi 1 vit	139,376,700	148,757,982
Totali	234,549,308	250,336,548

5.b.2. Llogari Kerkesa te tjera te arketueshme detajohet:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Tatim Fitimi	0	898
Mardhenie me grupin	59,575,390	
Totali	59,575,390	898



Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

6. Aktivet Afatgjata

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjate materiale, te cilat kane ndryshim nga viti kaluar si me poshte:

	Ndertesa	Mjete transporti	Makineri Pajisje	Inventar Ekonomik	Totali
<i>Aktive te Trapesuara</i>					
Gjendje 01.01.2019	98,212,742	26,903,161	660,753,710	114,153,150	900,022,763
Shtesa	0		13,752,731	9,635,117	23,387,848
Pakesime	0		-5,785,255	-7,697,526	-13,482,781
Gjendje 31.12.2019	98,212,742	26,903,161	668,721,186	116,090,741	909,927,830
<i>Amortizimi</i>					
Gjendje ne 01.01.2019	26,775,478	19,542,895	427,725,810	86,847,342	560,891,525
Shtesa llogaritur	3,571,863	1,472,053	35,206,020	6,806,085	47,056,021
Pakesime			-5,785,255	-7,697,526	-13,482,781
Gjendje ne 31.12.2019	30,347,341	21,014,948	457,146,575	85,955,901	594,464,765
<i>Vlera neto 01.01.2019</i>	71,437,264	7,360,266	233,027,900	27,305,808	339,131,238
<i>Vlera neto 31.12.2019</i>	67,865,401	5,888,213	211,574,611	30,134,840	315,463,065

Iventari i aktiveve afatgjate materiale eshte vleresuar me koston e marjjes se tyre.

a. Amortizimi

Amortizimi i Aktiveve afatgjate materiale eshte llogaritur sipas normave te nenit 22 te ligjit 8438 date 28.12.1998, "Per Tatimin mbi te ardhurat" ne vlere 47.056.021 leke vlere e cila eshte renduar ne shpenzime.



Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

7. Pasivet afatshkurtra

Pasivet afatshkurtera, perfaqesojne detyrime per tu paguar pas dates 31.12.2019 si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Hua Bankare	12,184,434	0
Te pagueshme ndaj furnitoreve	192,097,892	168,715,272
Te pagueshme ndaj punonjesve	26,285,755	21,964,779
Detyrime tatimore	9,410,841	4,048,974
Te tjera detyrime	0	608,360
Parapagime te arketuara	3,088,534	3,504,574
Totali	<u>243,067,456</u>	<u>198,841,958</u>

Hua Bankare jepet vlera e kredise afatshkurter te BKT

Llogari Te pagueshme ndaj furnitoreve detajohet:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Pa likujduar deri 6 muaj	18,883,776	16,585,197
Pa likujduar deri 1 vit	54,276,989	47,670,263
Pa likujduar mbi nje vit	118,937,127	104,459,812
Totali	<u>192,097,892</u>	<u>168,715,272</u>

7.b Detyrimet Fiskale


Llogarite e detyrimet fiskale ne pasiv te deklarimeve financiare paraqitet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
TVSH	1,341,502	206,694
Tatime te tjera	474,229	168,019
Sigurime shoqerore dhe TAP	7,595,110	3,674,261
Totali	<u>9,410,841</u>	<u>4,048,974</u>

Llogaritja e detyrimeve fiskale eshte bere konform ligjeve per TVSH, Tatimin mbi Te Ardhurat.

8. Pasivet Afatgjata

Pasivet afatgjata detajohen si me poshte:



Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Hua bankara Afatgjata	13,357,216	42,846,993
Humarje te tjera Afatgjata	-	2,871,251
Totali i pasiveve Afatgjata	13,357,216	45,718,245

Kredia BKT ne 31/12/2019	209, 637.6 euro ose 25.527.571 leke nga e cila:
Detyrime afat shkurtra	99,994.7 euro ose 12.170.355 leke
Detyrime afatgjata	109,642.9 euro ose 13.357.216 leke

9. Kapitallet e veta me vlere leke ka rritje nga viti kaluar leke, e detajuar sipas zerave:
 Shoqeria fitimin e vitit te kaluar e ka kaluar ne rezerve ligjore dhe rezerva te tjera.

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Kapitali	352,965,000	352,965,000
Rezerva Ligjore	815,216	815,216
Rezerva te tjera	30,339,415	27,863,103
Fitime te pa shperndara	0	0
Fitim (Humbj) e vitit financiar	1,793,225	2,476,312
	385,912,856	384,119,631

10. Shitjet neto

Shoqeria per vitin 2019 ka realizuar shitje neto si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Sherbime transmetimi	423,701,567	434,344,587
Prodhim spoti & punime TV	740,047	23,175
Totali	424,441,614	434,367,762

Te ardhurat ne bilanc nuk kuadrojne me shifren e afarizmit per vleren e autofaturimeve si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Te ardhurat ne FDP	441,936,982	448,391,104
Zbritur Autofaturimi	-17,911,463	-15,169,008
Mbyllje paradhenie	3,504,574	5,406,294
Diference kursi	-	-121,444
Parapagim	-3,088,535	-3,504,574
Totali Sipas Bilancit	424,441,558	435,002,372



Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

11. Mallra lende te para dhe sherbime

Ne kete ze perfshihen shpenzimet per materiale dhe te drejta transmetimi si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Mallra e materiale	38,843,493	8,968,052
Blerje e Drejta transmetimi	19,113,864	15,622,783
Totali	57,957,357	24,590,835

12. Shpenzime te tjera nga veprimtari e shfrytezimit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Shpenzime Energji	8,823,945	9,609,790
Shpenzime qira	12,959,141	18,130,340
Shpenzime te tjera	111,033,342	121,634,314
Sherbime nga te trete	11,710,954	10,888,354
Djeta	5,839,996	28,277,112
Shpenzime telefon	3,998,026	4,123,987
Sherbime bankare	727,330	162,458
Taksa	12,812,822	28,229,371
Shpenzime pritje	207,500	23,925
Penalitete& shpenz pa dokumenta	734,444	662,281
Totali	168,847,500	221,741,933

13. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Paga	133,323,165	119,509,601
Sigurime shoqerore	19,787,636	13,904,740
Totali	153,110,801	133,414,341

14. Amortizimi

Ne kete ze perfshihet amortizimi si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Amortizim Aktive Afatgjate Materiale	47,056,021	62,936,078
Totali	47,056,021	62,936,078



Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA
Shenime per Deklarimet Financiare
Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

15. Shpenzime Financiare

Ne kete ze perfshihen te ardhurat dhe shpenzimet si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
Fitim nga kembime valutore	8,539,519.00	19,631,349.85
Te ardhuranga interesat	11.12	121.44
Te ardhura te tjera	29.23	1,836.46
Shpenzim nga kembime valutore	-1,125,206.00	-2,879,579.63
Shpenzime per interesa	-2,645,004.00	-6,020,222.84
Totali	4,769,349	10,733,505

16. Fitimi Neto

Fitimi neto llogaritur si me poshte:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Fitim Bruto	2,239,284	3,030,180
Shpenzime te pa njohura	734,444	844,660
Baza llogaritjes Tatimit	2,973,728	3,874,840
% e tatim Fitimit	0.15	0.015
Tatim Fitimi	446,059	553,869
Fitimi NETO	1,793,225	2,476,311

17 Vijimesia

Drejtimi deklaron se shoqeria nuk ka probleme me vijimesine.

18. Ngjarjet pas dates se bilancit

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka patur ndikim të rëndësishëm në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit, të cilat përfshijnë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe mbylljen e shërbimeve jo thelbësore, kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjegjës me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka marrë një sërë masash në kuadër të ngadalësimit të përhapjes së virusit të cilat përfshijnë shtyrjen e kësteve të kredive për tre muaj për bizneset dhe individët të cilët kanë patur vështirësi ekonomike për shkak të masave të marra për ngadalësimin e përhapjes së virusit, shtyrjen e pagesave të qirave për tre muaj, si dhe një sërë masash për ndalimin e bizneseve që konsiderohen jo thelbësore dhe me rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe kufizimin e lëvizjes së lirë të njerzve brenda fashave orare të pacaktuara.

Shoqeria "MEDIA VIZION" SHA

Shenime per Deklarimet Financiare

Periudha 1 Janar-31 Dhjetor 2019

Shoqeria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korrigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e aktiviteteve më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare e cila mund të kërkojë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Nuk ka ngjarje të cilat kanë ndodhur pas datës së raportimit dhe që mund të kërkojnë rregullime apo informacione shtesë nga drejtimi i shoqërisë në lidhje me këto Pasqyra Financiare.

Financier

ALMA AVDIA



Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

GENCI DULAKU

